



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2024:033498

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05589470

C.nr.19/2024

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari G. A, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.U nga H i K. e Prishtinës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A. G avokat nga Gj. kundër të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit-Komuna e N. me objekt kontesti, kompensimi i diferences së pagës sipas inflacionit dhe kualifikimit shkollor, jashtë seancës, me datë 18.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I.APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses V. V nga Gj. dhe **DETYROHET** e paditura Drejtoria Komunale e Arsimit, Komuna e N. që paditëses t'ia paguajë në emër të pagesës së inflacionit për vitin 2021 sipas mesatares vjetore prej 3.40%, shumën prej 157.45 €, si dhe për vitin 2022 sipas mesatares vjetore 11.6%, shumën prej 634.80 €, dhe për shkakë të kualifikimit shkollor- superior, shumën prej 876.69€, e në tërësi shumën prej **1,668.94€**, me kamatë ligjore prej 8% nga data 26.01.2024, datë e ushtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmëris së këtij aktgjykimi, nën pasoja të përmbarimit të detyrueshëm.

II.Detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 134.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarës së saj me datën 30.01.2024, ka paraqitur padi kundër të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit-Komuna e Gj. me objekt kontesti, kompensimi i diferences së pagës sipas inflacionit dhe kualifikimit shkollor- superior. Në përmbajtjen e padisë i njëjti ka theksuar se paditësja është e punësuar si mësimdhënëse në Shkollën e Mesme Ekonomike në fshatin Ll , K. e N. dhe si mësimdhënëse-profesoresh e psikologjisë, asnjëherë nuk është kompensuar nga e paditura për kompensimi i diferences së pagës sipas inflacionit dhe kualifikimit shkollor superior nga data 01.02.2021 deri më 31.12.2022, andaj ka kërkuar që paditësit t'ia paguaj shumën prej 157.45 euro, në emër të pagesës së inflacionit për vitin 2021 sipas mesatares vjetore prej 3.40%, dhe për vitin 2022 sipas mesatares vjetore 11.6% t'ia

paguaj shumën prej 634.80 euro, për shkak të kulaifikimit shkollor shumën prej 876.69 euro , e në tërsi shumën prej 1,668.94€, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për taksën gjyqësore dhe për përpilimin e padisë, gjithsej shumën e përgjithshme prej 134.00€.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi të datës 22.02.2024, e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses pasi që ka konsideruar, se nuk ka bazë ligjore për pagesën e diferencës në pagë për periudhën nga 01.01.2021 deri me 21.11.2022. Më tej, ka theksuar se paditësja është e punësuar tek e paditura në shkollën e Mesme Ekonomike në N. Që nga themelimi i saj, e paditura ende nuk i ka paguar snjërit nga punëtoret diferencën në pagë. Po ashtu ka shtuar se Kontrata e Përgjithshme Kolektive në Kosovë nga viti 2017 dhe 2021, nuk paraqet bazë ligjore për arsye se egziston njoftimi nga Qeveria e Republikës së Kosovës , Ministria e Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit nr.OIB/488 nga 21 nëntor 2022, për shkëputjen e kontratës Kolektive të datës 20 Janar 2021, ashtu që kjo padi duhet të refuzohet si e pabazuar në ligj.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi të datës 22.02.2024, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (më tej: LPK) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera, për dhënien e vendimit merititor, pasi që nga përgjegjja në padi rezulton qartas se padia e paditësit është e themeltë.

Gjykata për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, në këtë çështje kontestuese i ka administruar këto prova materiale:

Nga leximi i Kontratës së Punës të datës 01.07.2022, u vërtetua se paditësja ka lidhur kontratë me të paditurën Komunën e N.-DKA, më dt.01.07.2022, për kohë të pacaktuar, ku e njëjta sipas kësaj kontrate është obliguar të punojë si mësimdhënës në SH.M. Ekonomike ne fshatin B. dhe Ll. K. N. në lëmin e psikologjisë.

Nga leximi i Vërtetimit të dt. 06.04.2023 i lëshuar nga SH.M. Ekonomike në fsh. Ll. me të cilën vërtetohet se paditësja për vitet shkollore nga data 01.09.2022 deri me datën 21.11.2022, ka 58 ditë pune.

Nga Lista e pagave për muajin nëntor 2022, u vërtetua fakti se paditësja ka pagën neto 441.19 €, përvoj pune 6 vjet, ndërsa për shkak të gradimit realizon shumën mujore në lartësi prej 58.32€.

Nga leximi i indeksit të harmonizuar të qmimeve të konsumit lëshuar nga Qeveria e Republikës-Agjensia e Statistikave të Kosovës, u vërtetua fakti se indeksi i harmonizuar i qmimeve të konsumit për vitin 2021 është në inflacionin vjetor 3.40%, ndërsa në vitin 2022 në inflacionin vjetor është në 11.60%.

Nga leximi i Diplomës me nr. 509/0715 e datës 08.07.2015, u vërtetu fakti se paditësja është mesimdhënës me diplomë të Kolegjit Fama , Baqelori i arteve psikologjike, që nga data 08.07.2015.

Gjykata duke pasur parasysh faktin se e paditura i ka pohuar faktet vendimtare, pra gjendjen faktike, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara konform nenit 398 të LPK-së.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “ *kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura.

Andaj, gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditëses dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës e Kolektive e Arsimit në Kosovë e vitit 21.01.2021, konkretisht nenin 35 paragrafi 5, 7 ,8 dhe 10 të kësaj Kontrate, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Kërkesa e paditëses për shpërblimin e inflacionit në pagë, bazën ligjore e ka në nenin 35 paragrafi 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë /Kontrata e datës 18.04.2017, ngase në nenin përkatës është përcaktuar se: “ *Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë.*”, e në rastin konkrete gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses në të dhënat se shkalla mesatare vjetore e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, për periudhën Janar -dhjetor 2021, mesataren vjetore prej 3.4% dhe për periudhën Janar-Nëntor 2022 dhe atë deri më datën 21.11.2022 (ngase kjo kontratë është shkëputur nga Qeveria e Republikës së Kosovës me këtë datë) mesataren vjetore prej 11.6%, të gjitha këto në vlerë të pagës bazë prej 421.00€, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit .

Me dispozitën e nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017 është përcaktuar se “Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit, edhe atë: 1.1. Mësimdhënës me Shkollë Normale, 10 % e pagës bazë; 1.2. Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare, 19 % e pagës bazë; 1.3. Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçare, magjistraturë/master dhe doktoraturë, 35 % e pagës bazë; 1.5. Përparimet në karriere, caktohet lartësia e pagës dhe lëvizja në gradim që përcillet me ngritje page 10 %”. Në rastin konkret u vërtetu fakti, se paditësja është mësimdhënëse me diplomë të Kolegjit Fama , Baqelori i arteve psikologjike, që nga data 08.07.2015 andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga leximi i Vendimit nr.01/33 e dt.29.08.2008, u vërtetua fakti se Qeveria e Republikës së Kosovës respektivisht kryeministri i saj më dt.29.08.2008, kishte marrë vendim që nga data 01.09.2008, të gjithë mësimdhënësit, drejtorët, zëvendës drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesional, do të kenë rritje të pagave në bazë të kriterëve të liqencimit. Nga ky vendim kanë përfituar mësimdhënësit, drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesional, 10% ata të cilët kanë qenë më diplomë të shkollës normale, 19% ata të cilët kanë qenë me shkollë të lartë pedagogjike, 27% të pagës bazë ata të cilët kanë diplomë universitare dhe 35% të pagës bazë ata të cilët kanë diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (magjistraturë dhe doktoraturë).

Me Ligjin e Punës nr.03-L/212 parashihet se sa i përket çështjeve të punëdhënësit me punëmarrësin ata të drejtat dhe detyrimet e tyre mund t'i rregullojnë edhe me Kontratë Kolektive dhe Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin, se sa të drejtat e përcaktuara me Ligj të punës, pra të drejtat e punëmarrësit me Kontratën Kolektive mund të avancohen më lartë se të drejtat e parapara me Ligjin e Punës.

Sa i përket pretendimit të palës së paditur se kërkesa e paditësit duhet të refuzohet, për shkak të se kjo kontratë është shkëputur më datën 21.11.2022, për gjykatën një pretendim i tillë është i pabazuar ngase e njëjta padinë e ka paraqitur në afatin e paraparë ligjore, që do të thotë se padinë e ka paraqitur pas arritjes së kërkesave për pagesë, përkatësisht për periudhën kohore nga data (01.02.2022 deri më 05.02.2023), ku vërtetohet me vërtetimin e lëshuar nga e paditura, se paditësja është në mardhënje pune tek e paditura. Ku edhe ka përvij pune prej 5 vite.

Kërkespadia e paditësit gjen mbështetje edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. GJ.A-Su.A 214/2023 të datës 09.10.2023, respektivisht në pikën II të dispozitivit të këtij mendimi.

Gjykata po ashtu konstaton se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditëses edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit/Kontrata nr.24. e datës 21.01.2021, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve/ Ligji nr. 04/L-077 datë 19.06.2012.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të LPK-së. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara i referohet shpërblimit për përpilimin e padisë në shumën prej 104€ dhe taksës gjyqësore për padi në shumën prej 20 €, e në shumën e përgjithshme prej 124€.

Duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjiilan –Dega Novobërdë
Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil
C.nr.19/2024, më datë 18.04.2024

Gjyqtari,
G. A

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate.